

ABDULLA REXHEPI

TURKU SI KONCEPTI I “TJETRIT” NË VEPRËN E ETËHEM HAXHIADEMIT

Si në shumë tekste letrare të autorëve shqiptarë, edhe në veprën e Etëhem Haxhiadimit “turku” shenjohej si koncept i Tjetrit të shqiptarit. Identifikimi i “Tjetrit” si objekt, në realitet është definim ose kuptimësim i “vetes”. Paraqitja e “Tjetrit” si i huaj, armik ose kundërshtar i “vetes”, më tepër është traditë e epistemologjisë moderne, gjë që nuk mund të vërehet gjithaq në tekstet klasike. Edhe në krijimtarinë letrare të Haxhiademit, si një krijimtari me bazë moderne, vërehet se “barbari” i tij është “Turku” dhe “Turqia”, si dhe figurat letrare-historike që sipas tij, u kanë shërbyer interesave të Perandorisë Osmane. Pra, në veprën e Haxhiademit, lexuesi nuk përballet vetëm me “Turkun” si koncept i Tjetrit, por ai lexon se edhe shenjime e definime të koncepteve të tjera për Tjetrin, siç është Hamzai që tradhton xhaxhanë e tij Skënderbeun, si dhe Zanfinën, e cila, shpreh gatishmëri t’i bashkohet armikut vetëm e vetëm që t’i hakmerret Skënderbeut.

Në këtë trajtesë shënjohej dhe analizohet krijimtaria letrare e Haxhiademit, në të cilën ai “turkun” e konceptualizon si Tjetrin e shqiptarit.

Në mendimin paramodern, theksi binte në institucionin e Bariut që kujdesej për “veten e të tjerëve”. Në kundërshtim me këtë qasje, zuri fill mendimi modern, i cili tërë fokusin e kishte te “vetja” e individit. Kështu, “Tjetri” si faktor kryesor për njohjen e vetes nga njeriu, filloi të zërë vend të rëndësishëm në dijet dhe

studimet shoqërore. Nga kjo epokë e këndeje, “Tjetri” është perceptuar si objekt nëpërmjet të cilit, individi njihet dhe kupton/kuptimëson vetveten. Në këtë traditë të mendimit, “Vetja” dhe “Tjetri” qëndrojnë përballë njëri-tjetrit. Sipas kësaj qasjeje, e cila i referohet filozofisë metafizike të Platonit, çdo gjë që nuk është “Vetja”, domosdoshmërisht duhet të jetë “Tjetri”, dhe anasjelltas. Brenda kësaj logjike, “Vetja” dhe “Tjetri” zënë vend në strukturën fizike dhe metafizike të lidhjes “ose ky ose ai”. Kështu, në bazë të kësaj tradite, bashkëveprimi me “Tjetrin” (gjinor, etnik, fetar, rajonal), nuk kishte ndonjë rol të rëndësishëm, andaj bota kuptohej e shpjegohej nga pikëpamja e “Vetes” dhe pa pjesëmarrjen e “Tjetrit”. Në këtë mënyrë, identitetet shoqërore janë ndërtuar në ndërvëprim me “të tjerët” dhe identiteti ynë ose i grupit (“ne”) ka rezultuar nga procesi i mendimit për “Veten” ose për “ne” në raport me “Tjetrin”. Ky është një proces egocentrik ose etnocentrik ku unë/ne shohim nga perspektiva jonë dhe përcaktojmë kush janë “të tjerët” e kush “ne”. Kështu “ne” nuk jemi “ata” dhe anasjelltas.

Prandaj, Levinas duke kritikuar filozofinë subjektiviste, sjell kritika konstruktive kundrejt epistemologjisë moderne. Sipas kësaj epistemologjie, mendimtari duke u mbështetur në cogito-n karteziante, çdo gjë tjetër e redukton në aktin “identifikues”. Ky mendim prodhoi një mendësi, sipas të cilës, njeriu/subjekti është vrojtues i gjithësisë dhe mendon se duke i sistematizuar dhe analizuar fenomenet dhe objektet e jashtme, mund ta njohë gjithësinë, dhe kështu, duke i njohur ato, në fakt, ai mëton t’i bëjë për vete dhe t’i sundojë ato. Sipas Levinas-it, këtu konceptualizimi, teorizimi dhe subjektivizimi i “tjetrit” shndërrohet në “identifikim”.¹

Një dikotomi e tillë vetidentifikuese mund të shihet edhe në një pjesë të krijimtarisë së Etëhem Haxhiademit. Në poezinë e tij, Shqipëria dhe shqiptari paraqitet si simbol i së mirës e lavdisë

¹ E. Levinas, *Otherwise Than Being or Beyond Essence*, 1998, f. 34-38.

absolute, ndërsa në anën tjetër, Turqia, Sulltani e turku në përgjithësi shpërfaqet si simbol i së keqes absolute, të cilin duhet ta asgjësojnë shqiptarët.

Por gjatë historisë, çdo popull ka pasur ose ka konstruktuar “barbarët” e tij. Shumë më herët, “barbari” për njeriun ishte natyra dhe kafsha. Por më pas, qëkur filloi të zhvillohej dhe të krijonte edhe më shumë, njeriut i hyri frika se atë mund t’ia përvetësonte dikush tjetër, prandaj, filloi të mendonte për ruajtjen e asaj që e kishte. Në këtë mënyrë, ai të huajin ose të panjohurin, filloi ta konsideronte si barbar, ose si Tjetrin e tij. Koncepti i barbarit është pjesë e pandashme e historisë së mendimit dhe shkrimit njerëzor. Edhe në tekstet e rilindasve vërejmë se “turku” është njëri nga konceptimet kryesore të Tjetrit të tyre. Në shumë vende, turku shënjohej dhe si “barbari”. Këtë koncept e hasim edhe në veprën e Haxhiademit.

*Kto un i shoh fort mir’; por për kët’ faj
Të tij a duhet edhe na pastaj
T’harrojm’ detyrat t’ona si Shqiptar
Dhe shtegun çel’ t’i lam’ Turkut barbar?²*

Këtu kuptojmë se shqiptari e ka për detyrë të punojë, të ndërtojë dhe të ruajë Shqipërinë dhe atë të mos ia lërë “turkut barbar”. Pra, shqiptari si Vetja te Haxhiademi, shënjon të mirën absolute, ndërsa në anën tjetër “turku barbar” është Tjetri që e rrezikon qenien e shqiptarit. Por më pas Haxhiademi nëpërmjet personazhit të tij Hamzai në dramën “Skënderbeu”, shtron një dilemë që si duket historikisht ka qenë e pranishme në mesin e shqiptarëve, e mbase është edhe sot. Dilema është nëse duhet pranuar një i huaj nga i cili ne mund të përfitojmë, apo duhet t’i bindemi një shqiptari të korruptuar moralisht?!

Haxhiademi thotë:

² E. Haxhiademi, “Skënderbeu”, në *Vepra* 2, Faik Konica, Prishtinë, 2000, f. 13.

Aasht ma mir' t'i bindem nji Shqiptari?

*Me faj a po t'i bindem nji barbari?*³

Në këto vargje dhe në shumë të tjera, që në fillim të kësaj drame vërehet lëkundja e besimit dhe skepticizmi i Hamzait, i cili shënjon dhe shqiptarin që i ka shërbyer Perandorisë Osmane. Këtë hamendje, Hamzait ia thëllon edhe më shumë Zanfina, e shoqja e Moisiut. Pra, Hamzait i shfaqet dyshimi nëse është më mirë t'i bindej Skënderbeut me faj, apo një të huaji, prej të cilit shumë shqiptarë kishin përfituar. Kështu, Haxhiademi në gojën e Zanfinës vë këta vargje:

“O princ, dhe Turku kur Shqipnin pushtoi,

Të drejtat e fisnikve i pranoi,

Krahinat e të parve ndën zotnim

Ç'do princi n'hije t'vet ja la trashgim,

Aq tepër lavdin t'on nuk e rrëmbeu

Sa kushërin' i gjakut Skënderbeu.

Kur paska ardh' veç vegjëlin të mprojë

Edhe traditat t'ona t'i shkretojë,

Ahere ç'far' ndryshimi nga barbari,

*Ka ky qi numurohet fis shqiptari?*⁴

Në vargjet e mësipërme, Haxhiademi, Turkun e vështron nga perspektiva e një shqiptari tjetër, pra, nga Zanfina, burri i së cilës iu është bashkuar ushtrisë turke në luftën kundër ushtrisë së Skënderbeut. Sipas kësaj qasjeje, turku edhe pse paska pushtuar Shqipërinë, por sundimin e krahinave ua paska lënë princërve vendorë dhe nga kjo më së shumti paska fituar vetë Skënderbeu. Këtu kuptojmë konstruktimin e Tjetrit brenda vetes, pra brenda llojit. Shqiptari, vetja, në këtë rast Zanfina, së cilës, Skënderbeu i ka marrë burrin e parë për ta martuar me motrën e tij, Mamicën, nuk sheh ndonjë ndryshim në mes turkut dhe kryeshqiptarit, Skënderbeut. Ajo gjithashtu nuk e konsideron të shëmtuar aspak

³ Ibid, f. 16.

⁴ Ibid, f. 17.

tradhtinë e Moisiut, por e ka hallin se pse ai ka ikur në Turqi e nuk ka vajtur në Venedik.

*Jo, jo, se kur të drejtën m'a pushton,
T'bashkohem me anmikun m'detyron.
Dhe n'asht se nderin Moisiu e fiku,
Pse shkoi n'Turqi e jo ke Venediku.⁵*

Me vargjet e këtij personazhi, Haxhiademi na shpërfaq një dimension të rëndësishëm njerëzor dhe në këtë rast të një shqiptari. Njeriu shpesh për shkaqe të ndryshme, por më së shumti kur mendon se i është shkelur e drejta që e ka merituar, nuk heziton t'i bashkohet edhe armikut dhe të luftojë për shkatërrimin e asaj gjëje, së cilës ai i përket. Pra këtu, Zanfina nuk e ka problem pse Moisiu ka shkelur nderin, por përse ai u është bashkuar turqve. Dhe në këto vargje manifestohen prirje më ekzistencialiste humane, se sa vetëm prirje politike e patriotike. Këtu kemi shpërfaqjen e zilisë, inatit, hakmarrjes, lakmisë, ambicies, e të tjera si këto, të cilat determinojnë konceptime dhe veprime ndonjëherë dhe në dëm të vetë asaj që subjekti është pjesë e saj.

Por konceptimi i turkut si Tjetri i shqiptarit në veprën e Haxhiademit kulmon në vargjet e mëposhtme, ku Skënderbeu i thotë Donikës:

*Ahere qenkemi n'rrezik përorë,
Kur na rrethuë kan dhet'tjer trathtorë.
Me gjith' kto fjalë un ende nuk besoj,
Prandaj edhe nji her' do t'ahetoj
Qëndrimin e t'im nipi kundrejt meje.
Ay në të vërtet' shqiptar ndër deje
Asht gjymës, se e ka t'amën turkeshë,
Dhe nga ajo më vjen dyshim, mbretneshë.⁶*

⁵ Ibid, 17.

⁶ Ibid, f. 48.

Pra sipas vargjeve, Hamzai është shqiptar dhe si rezultat nuk mund të jetë tradhtar. Por ama, meqë e ka nënën turke, atëherë edhe mund të bëjë një gjë të tillë. Edhe këtu, theksi vihet te e keqja, te turku, në këtë rast te turkesha, nëna e Hamzait. Ky i fundit, nga autori, shihet si një subjekt i ndarë në dy gjysma, ku njëra gjysmë është e mira, e moralshmja, shqiptarja e cila nuk mund të tradhtojë, kurse gjysma tjetër është e keqja, e pamoralshmja, pjesa turke, ajo që tradhton. Tradhtia e Hamzait, pra, nuk ka rezultuar nga ndonjë ndjenjë tjetër e tij ekzistenciale, por nga fakti se gjysma e tij kishte gjak turku. Këtu del në pah dhe pretendimi i fillimshekullit të kaluar, i kohës kur jetonte dhe autori, se etnia e subjektit është e ngjizur me gjakun e tij, e ajo nuk është një konstrukt social si çdo gjë tjetër.

Edhe në vargjet e poezisë “Naim Frashëri”, të Haxhiademit, lexojmë vargjet si:

*O kangëtor hyjnor, a po qetsohe,
Në pellgun e vorrezve të shkretuëme,
Prej kohës të harruëme,
Qi pasqyrohenn 'ujin e Bosforit?
Pastaj,
Mbi vorrin tand e bani ben shqiptari,
Qi sa të shkoj' barbari,
Të sjellin n'gji t'atdheut shtruë me dafine;⁷*

*Ti qe, o shpirti vlershëm, nga tëparët,
Qi n'ditët ma të errta të skllavnis,
I këshillove ambël qytetarët
Të mos duroshin zgjedhën e Turqis
Dhe u përmende cilët jan' shqiptarët,
Qi përqafoshin bishën e Asis.⁸*

⁷ E. Haxhiademi, “Lyra”, në *Vepra* 2, Faik Konica, Prishtinë, 2000, f. 250-251.

⁸ *Ibid*, f. 276.

Krijimtaria letrare, siç vërehet në poezitë e sipërpërmendura të Haxhiademit, është rezultat i përvojave shpirtërore kolektive të popujve, të cilat janë strukturuar prej përjetimeve të tyre tragjike përgjatë historisë. Kuptimi i dramës epike si përjetim shpirtëror rrjedh nga fakti se aktualisht populli nuk ballafaqohet realisht (fizikisht) me ngjarjen e përshkruar në ep, e cila mund të ketë ndodhur shekuj më parë.

Këtu fillon të veprojë dimensionimi imagjinar i artit simbolik, i cili gjithnjë është vital e i freskët. Kështu, misioni i poetit epik është që të ndërtojë lidhje midis trashëgimisë shpirtërore dhe ideale të popullit me kërkesat dhe nevojat aktuale të atij. Krijimi i kësaj lidhjeje nuk mund të bëhet ndryshe pos me koncepte, arketipa dhe struktura simbolike. Siç duket, edhe në kohën kur jetonte poeti, shqiptarët akoma përballeshin me praninë e ideologjisë turkiste, prandaj duke e ndjerë nevojën e kohës për ndërtimin e kombit dhe shtetit shqiptar, Haxhiademi krijoi dramën e tij epike, nëpërmjet të cilës, shqiptarët e kohës së tij i ndërlidhte me ngjarje dhe personazhe të para shumë shekujve, siç ishte Skënderbeu. Por për të forcuar këtë vetëdije kombëtare, autorit i duhej një vetëdije ose një subjektivitet “tjetër”, mbi të cilën do të përcaktonte kush dhe si janë “shqiptarët”. Pra, Haxhiademi duke identifikuar “turkun” si simbol i së keqes, në fakt si antipod të tij po konstruktonte “shqiptarin” si simbol të së mirës.

Në këtë traditë bashkëveprimi me “Tjetrin” (gjinor, etnik, fetar, rajonal), ai nuk kishte ndonjë rol të rëndësishëm, andaj bota kuptohej e shpjegohej nga pikëpamja e “vetes” dhe pa pjesëmarrjen e “Tjetrit”. Prandaj për të krijuar vetëdijen kombëtare, Haxhiademit i duhej një objekt “Tjetër”, mbi të cilën do të përcaktonte kush dhe si janë “shqiptarët”. Pra, Haxhiademi duke identifikuar “turkun” si simbol i të keqes, në fakt si antipod të tij po konstruktonte “shqiptarin” si simbol të së mirës.

Sipas kësaj hermeneutike filozofike, raporti midis “vetes” dhe “tjetrit” definohet mbi bazën e ndërveprimit mes subjektivitetit

dhe objektit. Sipas këtij mendimi, subjekti (vetja) në pozitën e vrojtuesit/kuptimësuesit dallon rrënjësisht nga objekti (tjetri) në pozitën e të vrojtuarit/të kuptimësuarit. Një qasje e tillë pati një ndikim të madh në ndërtimin e mendësisë moderne utilitariste në botë. Nga kjo traditë rezultuan dikotomitë e bazuara në kategori gjinore, racore, klasore, fetare, atë të seksualitetit, e të tjera.

Përfundim

Në fund mund të thuhet se në dramën “Skënderbeu” të E. Haxhiademit, lexuesi nuk përballet vetëm me “Turkun” si koncepti i Tjetrit, por ai mund të hasë dhe koncepte të tjera të “të tjerëve”, siç është Hamzai, i cili kishte tradhtuar xhaxhanë e tij, jo për diçka tjetër, por për shkak se kishte nënë turke. Pastaj kemi Zanfinën, e cila është e gatshme t’i bashkohet armikut, nga ndjenja e saj e hakmarrjes ndaj Skënderbeut. Në fakt, kjo dhe është magjia e tekstit letrar i cili shpërfaq horizonte dhe dimensione të ndryshme dhe shpeshherë kundërthënëse të vetëdijes individuale dhe vetëdijes kolektive. Pallatin e Skënderbeut në Krujë dhe personazhet e kësaj drame duhet t’i konsiderojmë edhe si shpërfaqje të një vetëdijeje kolektive shqiptare të kohës së Haxhiademit.

BIBLIOGRAFI

- Haxhiademi, E., “Lyra”, në *Vepra 2*, Faik Konica, Prishtinë, 2000.
- Haxhiademi, E., “Skënderbeu”, në *Vepra 2*, Faik Konica, Prishtinë, 2000.
- Haxhiademi, E., *Lyra (Seria klasikët/poezi)*, Botimet Poeteka, Tiranë, 2019.
- Levinas, E., *Otherwise Than Being or Beyond Essence*, Duquesne University Press, 1998.